

SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKTI: Blerje baze materiale per shërbime riparimi akseve te rrugeve rurale

1. ÇAKULL MAKINERIE

Çakulli i makinerise eshte material me perberje granulometrike 20~50mm me perberje te grimcave argjilore jo me teper se 10%, dhe pas hapjes ne objekt behet ngjeshja me makineri.

- Perberja granulometrike per furnizim do te jete sipas fraksioneve :
 - Fraksioni 20-30m/m sasia 100m³
 - Fraksioni 30-40m/m sasia 100m³
 - Fraksioni 40-50m/m sasia 200m³
- Furnizimi I sasive dhe perberjeve granulometrike te çakullit te makinerise do te behet sipas percaktimeve te Bashkise Shkoder, ne varesi te gjendjes se rrugeve rurale dhe nevojave te Njesive Administrative ne vendet e percaktuara prej saje.
- Shtresat e çakullit me trashesi te ndryshme sipas gjendjeve te rrugeve qe do te riparohen pas perhapjes se tyre duhet te lagen perpara pastaj te behet ngjeshja me makineri. Shtresat duhet te jete te pastra pa permbajtje dherash apo materiale te tjera.
- Trashesia per mbushje te kasonetes dhe profilim e ngjeshje me makineri duhet te jete jo me teper se 150 mm.

2. ÇAKULL GURORE (Mbeturine kava).

- Shtresa e çakullit mbeturine kave duhet te plotesoj keto kushte:
- Indeksi i plasticitetit nuk duhet te kaloje 10
- Nuk duhet te permbaj grimca me te medha se 2/3 e shtreses ne sasi mbi 5%
- Nuk duhet te permbaj mbi 10% grimca argjilore. Trashesia e shtreses te kasonetes do te jete jo me teper se 150 mm
- Siperfaqja e perfunduar e ngjeshur nuk duhet te kaloj ± 20 mm
- Inertet e trasha do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjerre ose nje kombinim i tyre me nje mase jo me shume se 20 mm dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne Inertet e trasha nuk duhet te kalojne me shume se 3 %.

- Furnizimi I sasive te çakullit te gurores do te behet sipas percaktimeve te Bashkise Shkoder, ne varesi te gjendjes se rrugeve rurale dhe nevojave te Njesive Administrative ne vendet e percaktuara prej saje.

3. **ZHAVORE LUMI**

- Materialet e përshtatshme do të përfshijnë të gjitha materialet që janë të pranueshme në përputhje me kontratën për përdorimin në punimet dhe që janë në gjendje të ngjeshen në një mënyrë të specifikuar për të formuar mbushje ose trase.
- Materialet e përdorura si zhavore lumi duhet të përfitohen nga burimet e njohura dhe të licencuara që sigurojnë rezultate të kënaqshme për përdorim. Inertët e përdorura do të jenë të imta dhe të trasha. Ato do të përdoren sipas një raporti të dhënë në KTZ përkatëse.
- Zhavoret e lumit duhet të jenë pa masë të mpiksura, cila të buta e të vecanta, vajra distilimi, alkale, lëndë organike, argjile dhe sasi të substancave të tjera demtuese me përmbajtje maksimale të lejueshme të lymit dhe substancave të tjera demtuese jo më tepër se 5 %.
- Furnizimi I sasive të zhavorit të lumit do të bëhet sipas përcaktimeve të Bashkisë Shkoder, në varesi të gjendjes së rrugëve rurale dhe nevojave të Njesive Administrative në vendet e përcaktuara prej saje.

4. **FURNIZIMI**

- Furnizimi do të bëhet sipas kërkesës të Bashkisë Shkoder brenda afatëve të përfundimit të kontratës me mjetet e kontraktorit sipas distancave mesatare të preventivit të ofertës

Punoj

Ing. Astrit Sokoli